



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 19621 prot

Pukë, më 22 10 .2024

V E N D I M

Nr. 46, datë 16.10.2024

“PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE PËR SHITJEN ME ANKAND TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT”FK TËRBUNI”SHA ME NIPT L19704301F NË MASEN 100% “

Mbështetur në nenin 113,pika 2 të ligjit nr.8417,datë 21.10.1998”Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar ,nenit 8,pika 2,neni 9 pika 1,nënpika 1.1 shkrona “b”,nën pika 1.2 ,shkronja “a”,nenit 54 gërma”e” të ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 “Per Vetëqeverisje Vendore”i ndryshuar, ligjit nr.9901 ,datë 14.04.2008 “Për tragtarët dhe shoqëritë tregtare”të ndryshuar ,Ligjin nr.105/2020 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.79/2017“Për Sportin”,Ligjit nr.9874 ,dt.14.02.2008”Për ankandin publik” i ndryshuar ,themeluar si Shoqeri Aksioner me date 14.10.2011 ,me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 16.10.2024, pas shqyrtimit dhe diskutimit të anëtareve në perfundim :

VENDOSI:

1. Dhënie e pëlqimit për fillimin e procedurave ligjore për shitjen me Ankand në masen 100% të aksioneve që Bashkia Pukë zotëron si aksionere e vetme në Shoqërine Klub Futboll “Tërbuni”sh.a
2. Të merren masat që të përcaktohen sipas procedurave ligjore ekspertët përkatës për hartimin e raportit të vlersimit të aksioneve dhe përcaktimin e vlerës minimale të shitjes.
3. Forma e shitjes së aksioneve që zotërohen nga Bashkia Puke në Shoqërinë Klub Futboll Tërbuni të bëhet nepërmjet proçedurës konkurruese, Procedure e Hapur Standart e Ankandit.
4. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë Pukë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.
6. Vendimi u shpall me date 18.10.2024.
Vota te vlefshme gjithsej 12
Vota pro 12, vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 729/1 prot.

Shkodër, më 01.11.2024



LËNDA: Mbi vendimin Nr.46, datë 16.10.2024 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175/2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54/e, neni 55/4, neni 64/c, Ligjin Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, VKB Pukë Nr.14/2020 “Mbi miratimin e rregullores së brendshme të Këshillit Bashkisë Pukë”, dokumentacionit i dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Pukë Nr.1896/3prot datë 22.10.2024 shqyrtoi **VKB Pukë nr.46 datë 16.10.2024 “Për dhënie pëlqimi për fillimin e procedurave ligjore për shitjen në ankand të aksioneve të klubit të futbollit FK Tërbuni”**, sh.a, në masën 100%”.

Pas trajtimit të vendimit, konstatohet si vijon:

1. Vendimi i Këshillit Bashkiak Pukë Nr.46, datë 16.10.2024 është trajtuar dispozita 54/e e Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nen që ju detyron të zhvilloni seanca konsultimi përpara shqyrtimit dhe miratimit të aktit në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe rregullores së Këshillit Bashkiak Pukë, kreu II, neni 152, shtojca Nr.19 e VKB Pukë Nr.14/2020 “Mbi miratimin e rregullores së brendshme të Këshillit Bashkisë Pukë”,
2. Relacioni bashkëlidhur vendimit shprehet “sipas kërkesave të Federatës Shqiptare të Futbollit dhe të KLSH”, të cilat nuk janë depozituar së bashku me vendimin. Sipas parashikimeve Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175/2020 kreu II, neni 4, shkronja “c” dhe “d, të depozitohen shkresat te njehsuara me origjinalin.

Për sa trajtuar, Prefekti nuk ju autorizon procedim të mëtejshëm ligjor.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI

